REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

Nr.2865 prot

Datë 03.11.2025

URDHËR

Nr. 316, datë 03.11.2025

PËR

"MIRATIMIN E METODOLOGJISË TË PËRCAKTIMIT TË MASËS SË DËNIMIT ADMINISTRATIV GJOBË"

Në zbatim të nenit 45, të pikës 2, të ligjit nr. 25/2024, "Për sigurinë kibernetike", si dhe ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative",

URDHËROJ:

1. Miratimin e metodologjisë për përcaktimin e masës së dënimit administrativ gjobë sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Igli T[illegible]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE - KËSHILLI I MINISTRAVE

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II" nr.3Tiranë;
Faqe web: www.aksk.gov.al E-mail: info@aksk.gov.al
Tel./Fax : 04 2221 039

METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË DËNIMIT ADMINISTRATIV GJOBË

Tabela e përmbajtjes

I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo metodologji përcakton rregullat e përgjithshme bazë për përcaktimin e masës së dënimit administrativ gjobë në zbatim të nenit 45, të pikës 2, të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", ligjit nr.10279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.531, datë 25.09.2025 "Për përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë kibernetike dhe kategorizimin e afateve të masave korrigjuese në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit", si dhe rregullores "Për kategorizimin e incidenteve të sigurisë kibernetike" miratuar me urdhër nr. 299, datë 21.08.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit.
2. Objekti i kësaj metodologjie është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për konstatimin, shqyrtimin dhe vendosjen e masës së dënimit administrativ ndaj operatorëve të infrastrukturave të informacionit, punonjësve të Autoritetit, në rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike" si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3. Qëllimi i kësaj metodologjie është të sigurojë zbatim të njëtrajtshëm, proporcional dhe të drejtë të masës së gjobës, në funksion të forcimit të zbatueshmërisë së legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike dhe parandalimit të shkeljeve të mëtejshme.
4. Kjo metodologji zbatohet nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në rastet kur gjatë procesit të ushtrimit të kontrollit në infrastrukturat e informacionit konstatohet nga grupi i kontrollit mos zbatimi i kërkesave ligjore të legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike të cilat nuk përbëjnë kundërvajtje penale, si dhe për shkeljet e konstatuara për punonjësit e Autoritetit të cilët nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në ligjin "Për sigurinë kibernetike" për sa i përket ruajtjes se konfidencialitetit gjatë trajtimit të një incidenti kibernetik.
5. Termat e përdorura në këtë metodologji kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuara në ligjin nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
   a) **"Dënim administrativ"** është masa e gjobës dhe çdo masë apo sanksion tjetër administrativ, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike apo aktet e tjera nënligjore.
   b) "**Gjobë**" është dënimi administrativ kryesor në vlerë monetare, që sanksionon shkeljen e kërkesave ligjore nga operatorët e infrastrukturave të informacionit ku dëmi i shkaktuar është i rëndësishëm dhe që ka për qëllim kthimin e aktivitetit që kontrollohet në kushtet e zbatimit të kërkesave ligjore.
   c) **"Subjekt kontrolli**" i referohet operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, të cilët kanë detyrimin e përmbushjes së kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike.
   ç) **"Parimi i proporcionalitetit**" konsiderohet parimi sipas të cilit ushtrohet kontroll dhe merren masa administrative lidhur me veprimtarinë e subjektit që kontrollohet, duke siguruar që masa administrative e vendosur:
      - është e nevojshme për arritjen e qëllimit ligjor të garantimit të nivelit të duhur të sigurisë kibernetike;
      - është e përshtatshme dhe efektive për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve dhe për të nxitur pajtueshmërinë me kërkesat ligjore; si dhe

- është në përpjesëtim të drejtë me natyrën, rrethanat, pasojat dhe nivelin e përgjegjësisë së subjektit që ka kryer shkeljen, duke shmangur çdo penalizim të tepruar apo të panevojshëm.

6. Në përcaktimin e masës së dënimit apo të masës administrative që duhet të marrë, grupi i kontrollit, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara dhe pasojave të tyre, duke respektuar parimin e proporcionalitetit, vendos atë sanksion apo merr atë masë që është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës, dhe që cenon më pak të drejtat apo interesat e ligjshme të subjektit të kontrolluar.

II. DËNIMET ADMINISTRATIVE

1. Llojet dhe vendosja e dënimit administrativ

1.1 Shkelja e kërkesave ligjore nga operatorët e infrastrukturave të informacionit, që konstatohen nga grupi i kontrollit, kur nuk përbën kundërvajtje penale, përbën kundërvajtje administrative.

1.2 Shkeljet e konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të kontrolluar klasifikohen si kundërvajtje administrative për të cilat parashikohen dënimet administrative, si vijon:

a) Dënim me gjobë;

b) Kërkesë institucionit kompetent për pezullim e ushtrimit të shërbimit, në rastet e shkeljeve të përsëritura për mos përmbushjen e masave të sigurisë, kur ndaj operatorit të infrastrukturës kritike janë marrë deri në 2 (dy) masa administrative të njëpasnjëshme.

1.3 Dënimi administrativ, kur është e nevojshme, shoqërohet edhe me urdhërimin e subjektit të kontrolluar për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për t'i eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm kohor për këtë qëllim. Në përcaktimin e afatit, grupi i kontrollit merr në konsideratë nivelin e rrezikut të shkeljes, pasojat e saj dhe rrethanat konkrete që përcaktojnë kohën e nevojshme për kryerjen e veprimeve për këtë qëllim, me përpjekjet maksimale nga ana e subjektit të kontrolluar.

1.4 Për çdo shkelje të kërkesave ligjore do të zbatohet dënimi administrativ propocional, i cili duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të shkeljes, parandalimin e përsëritjes së saj në të ardhmen, si dhe për të adresuar mungesën e bashkëpunimit nga ana e subjektit të kontrolluar.

III. KRITERET PËR CAKTIMIN E DËNIMIT ADMINISTRATIV GJOBË

1. Dënimi administrativ gjobë

1.1 Dënimi administrativ gjobë, është dënimi administrativ i cili i jepet operatorit të infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të informacionit, kur nuk plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

1.2 Masa e gjobës është e shprehur me intervale sipas pikëve të grumbulluara, përqindjes (%) së përmbushjes së masave të sigurisë kibernetike, si dhe vlerësimit të nivelit të rrezikut sipas përcaktimeve të bëra në këtë metodologji.

1.3 Kriteret e përcaktimit të vlerës së gjobës bazohen në:

a) Përqindjen (%) e përmbushjes së masave teknike, organizative dhe operacionale të sigurisë kibernetike, të përcaktuara në ligjin nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 25.09.2025 "Për përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë

kibernetike dhe kategorizimin e afateve të masave korrigjuese në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit";

b) Nivelin e rrezikut të sigurisë në infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit;

c) Kategorinë e incidenteve kibernetike dhe impaktin e tyre;

ç) Nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;

2. Rastet e dhënies së dënimit administrativ gjobë

2.1 Autoriteti, bazuar në përcaktimet e kësaj metodologjie përcakton vlerën e gjobës brenda kufirit minimal dhe maksimal të parashikuar në ligjin nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

2.2 Ndaj operatorëve të infrastrukturave kritike të informacionit dhe operatorëve të infrastrukturave të rëndësishme të informacionit jepet dënimi administrativ gjobë si vijon:

a) Mosraportimi pranë CSIRT-it Kombëtar dhe CSIRT-it sektorial i incidenteve të sigurisë kibernetike të ndodhur në infrastruktura, në zbatim të shkronjës "ë", pika 3, neni 17, dhe pika 3, neni 23 e ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, në vlerë nga 1 000 000 lekë deri në 10 000 000 lekë;

b) Mosraportimi i saktë i infrastrukturave të informacionit gjatë procesit të identifikimit, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, përbën, kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, në vlerë nga 200 000 lekë deri në 400 000 lekë;

c) Mosraportimi pranë Autoritetit të pikës së kontaktit apo i përditësimeve të tyre, sipas përcaktimeve në pikat 3 dhe 4, të nenit 18, të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", përbën, kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, në vlerë nga 200 000 lekë deri në 400 000 lekë;

ç) Mospërmbushja e detyrimeve nga ana e operatorëve sipas përcaktimeve në pikat 1, 3, 4, 5, 7, dhe 8 dhe 9 të nenit 31 të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", përbën, kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë 1 000 000 lekë deri në 10 000 000 lekë;

d) Mospërmbushja nga ana e operatorëve e detyrimeve të përcaktuara në kuadër të marrjes së masave korrigjuese, në zbatim të pikave 1, 2, 4 të nenit 43, të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", përbën, kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë 400 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

dh) Mospërmbushja nga ana e operatorëve e detyrimeve, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të nenit 23 të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", përbën, kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë në vlerë nga 200 000 lekë deri në 400 000 lekë;

e) Mospërmbushja nga ana operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit të administratës publik, e detyrimeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 32 të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike" përbën, kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë në vlerë nga 2 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë;

ë) Mospërmbushja e detyrimeve për nëpunësit e Autoritetit, sipas përcaktimeve në nenin 27 të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, në vlerë nga 200 000 lekë deri në 400 000 lekë.

IV. METODOLOGJIA E PËRCAKTIMI TË DËNIMIT ADMINISTRATIV GJOBË

1. Përcaktimi i dënimeve administrative për mospërmbushjen e detyrimeve të raportimit të incidenteve kibernetike nga operatorët e infrastrukturave të informacionit

1.1 Operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit janë të detyruar të raportojnë të gjitha llojet e incidenteve të sigurisë kibernetike pranë CSIRT-it Kombëtar dhe CSIRT-it sektorial, brenda 4 orëve nga momenti i identifikimit të incidentit kibernetik. Në rastin e incidenteve të rëndësishme, operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit brenda 72 orëve nga momenti i identifikimit të incidentit kibernetik të rëndësishëm përditësojnë informacionin dhe bëjnë një vlerësim fillestar të incidentit kibernetik të rëndësishëm, duke përfshirë ashpërsinë dhe ndikimin, si dhe, aty ku ka, treguesit e kompromentimit.

1.2 Subjektet të cilët nuk raportojnë incidentet kibernetike sipas pikës 1.1 të kreut IV të kësaj metodologjie, do të sanksionohen me gjobë në bazë të:

a) Kategorisë së incidentit kibernetik, të përcaktuar në rregulloren "Për kategorizimin e incidenteve të sigurisë kibernetike" miratuar me urdhër nr. 299, datë 21.08.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit;
b) Në bazë të shërbimit kritik ose shërbimit të rëndësishëm;
c) Vlerësimit të nivelit të rrezikut;
ç) Kohës së përcaktuar të raportimit.

1.3 Mospërmbushja e detyrimit të raportimit të incidenteve kibernetike nga operatorët e infrastrukturave të informacionit sanksionohet me gjobë në vlerat e përcaktuara në tabelën si vijon:

Klasifikimi i incidenteve kibernetike sipas ndikimit	**Koha e raportimit**	**Masa e gjobës për operatorët e infrastrukturave kritike**	**Masa e gjobës për operatorët infrastrukturave të rëndësishme**
Incidentet kibernetike me ndikim **të lartë**	Brenda 4 orësh nga identifikimi	8 000 000 lekë	5 000 000 lekë
Incidentet kibernetike me ndikim **të mesëm**	Brenda 4 orësh nga identifikimi	5 000 000 lekë	3 000 000 lekë
Incidentet kibernetike me ndikim **të ulët**	Brenda 4 orësh nga identifikimi	2 000 000 lekë	1 000 000 lekë

Tabela nr.1

Shënim Kategoritë e incidenteve të sigurisë kibernetike janë përcaktuar në nenin 6, të rregullores "**Për kategorizimin e incidenteve të sigurisë kibernetike**", miratuar me urdhër nr. 299, datë 21.08.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit.*

1.4 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, pavarësisht nivelit të ndikimit të incidentit kibernetik, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 10 000 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

2. Përcaktimi i dënimeve administrative në rast të mospërmbushjes së detyrimit për dorëzimin e raportit përfundimtar të incidentit pranë CSIRT-it Kombëtar, si dhe mosdorëzimi i raportit të progresit në rast incidenti kibernetik të vazhdueshëm

2.1 Bazuar në nenin 23, pikat 5 dhe 6 të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit kanë detyrimin që brenda 1 (një) muaji pas njoftimit të incidentit, të dorëzojnë pranë CSIRT-it Kombëtar një raport përfundimtar, i cili përmban:

a) një përshkrim të detajuar të incidentit, duke përfshirë rëndësinë dhe ndikimin e tij;
b) llojin e kërcënimit ose shkakun kryesor që mund ta ketë shkaktuar incidentin;
c) masat e zbatuara dhe masat e vazhdueshme për zvogëlimin e pasojave;
ç) aty ku është e aplikueshme, ndikimin ndërkufitar të incidentit.

2.2 Në rastet e një incidenti kibernetik të vazhdueshëm, operatori i infrastrukturës së informacionit i prekur nga ky incident, përveç detyrimit të dorëzimit të raportit përfundimtar, ka detyrimin të dorëzojë pranë CSIRT-it Kombëtar edhe një raport progresi në kohën e ndodhjes së incidentit kibernetik.

2.3 Bazuar në nenin 44, shkronja "e", të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", mosdorëzimi i raportit përfundimtar/ raport progresit, përbën, kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si me poshtë vijon:

Klasifikimi i incidenteve kibernetike sipas ndikimit	**Masa e gjobës në rast të mosdorëzimit të raportit përfundimtar/ raport progresit të incidenteve të ndodhura në operatorët e infrastrukturave kritike**	**Masa e gjobës në rast të mosdorëzimit të raportit përfundimtar/ raport progresit të incidenteve të ndodhura në operatorët e infrastrukturave të rëndësishme**
Incidentet kibernetike me ndikim **të lartë**	350 000 lekë	300 000 lekë
Incidentet kibernetike me ndikim **të mesëm**	300 000 lekë	250 000 lekë
Incidentet kibernetike me ndikim **të ulët**	250 000 lekë	200 000 lekë

Tabela nr.2

2.4 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, pavarësisht nivelit te ndikimit te incidentit kibernetik, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 400 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

3. Përcaktimi i dënimeve administrative për mosraportim pranë Autoritetit i pikës së kontaktit apo përditësimi i tyre.

3.1 Bazuar në shkronjën "f", të nenit 16, si dhe në nenin 18 të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", CSIRT-i sektorial cakton pikën e kontaktit dhe raporton të dhënat pranë CSIRT-it Kombëtar. Operatorët e infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të informacionit caktojnë pikat e kontaktit dhe raportojnë të dhënat tek CSIRT-it Kombëtar dhe CSIRT-it sektorial. Çdo ndryshim në të dhënat e pikave të kontaktit duhet t'i komunikohet CSIRT-it Kombëtar dhe CSIRT-it sektorial brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike.

3.2 Mosraportimi i pikës së kontaktit apo i përditësimeve të tyre, përbën, kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë vijon:

a) mosraportimi i pikës së kontaktit nga operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit (OIKI) apo i përditësimeve të tyre, dënohet me gjobe me vlerën me 300 000 lekë;

b) mosraportimi i pikës së kontaktit nga operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit(OIRI) apo përditësimi i tyre dënohet me gjobë me vlerën me 200 000 lekë.

3.3 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 400 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

4. Përcaktimi i dënimeve administrative për mospërmbushjen e masave korrigjuese

4.1 Bazuar në nenin 43, pika 1, të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", kur Autoriteti konstaton mangësi në zbatimin e masave të sigurisë përcakton një afat të arsyeshëm brenda të cilit operatorët e infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të informacionit duhet të marrin masat korrigjuese përkatëse. Përcaktimi i këtij afati të arsyeshëm bëhet në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.531, datë 25.09.2025 "Për përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë kibernetike dhe kategorizimin e afateve të masave korrigjuese në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit".

4.2 Bazuar në nenin 44, shkronja "dh", të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike" mospërmbushja e masave korrigjuese nga ana e operatorëve të infrastrukturave të informacionit do të sanksionohet me gjobë sipas kësaj metodologjie.

4.3 Për qëllime të vlerësimit të nivelit të mosrealizimit të masave të sigurisë kibernetike të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.531, datë 25.09.2025 "Për përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë kibernetike dhe kategorizimin e afateve të masave korrigjuese në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit", si dhe përcaktimit të masës përkatëse të dëmit administrativ (gjobë), kjo metodologji përcakton rregullat, kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të mospërmbushjes së masave të sigurisë kibernetike bazuar në peshën specifike të secilës masë sigurie sipas Aneksit 1 të kësaj metodologjie, si dhe në përqindjen e realizimit të secilës masë të aplikuar.

4.4 Për secilën kategori të masave organizative, teknike dhe operacionale, paraqitet tabela e mëposhtme:

MASA ORGANIZATIVE, TEKNIKE DHE OPERACIONALE	**Pesha për masë (Aneksi nr 1)**	**Përqindja e realizimit të masës (përcaktohet nga Grupi Kontrollit 0-100%)**
MS – 1	-	-
MS – 2	-	-
:	-	-
:	-	-
MS – (N)	-	-

Tabela nr. 3

4.5 Në këtë strukturë:

- **Masa** : identifikon emërtimin e masës së sigurisë kibernetike;
- **Pikët e peshës** janë përcaktuar për secilën masë sigurie të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.531, datë 25.09.2025 "Për përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë kibernetike dhe kategorizimin e afateve të masave korrigjuese në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit", nga Grupi i Kontrollit, bazuar në kategorizimin dhe rëndësinë e tyre sipas Aneksit nr. 1 të kësaj metodologjie.
- **Përqindja e realizimit të masës** vlerësohet gjatë procesit të kontrollit nga Grupi i Kontrollit për secilën masë. Të gjitha masat e sigurisë kibernetike pjesërisht të realizuara, apo të pa realizuara, i nënshtrohen vlerësimit sipas formulës në pikën 4.7, të kreut IV të kësaj metodologjie.

4.7 Formula e përllogaritjes së përqindjes totale të mosrealizimit të masave të sigurisë kibernetike është si vijon:

Përqindja e parealizuar = shuma [pesha për masë (pa realizuar, pjesërisht realizuar) * (100% - përqindja e realizimit të masës)] / totali i peshave për masat e aplikuara

Nivelet e vlerësimit të mosrealizimit të masave të sigurisë dhe gjobat përkatëse janë sipas tabelës si më poshtë vijon:

Niveli	**Totali i përqindjes së mosrealizit (%)**	**Gjoba (Lekë)**
Niveli 0	0% – 10%	0
Niveli 1	11% – 20%	400 000
Niveli 2	21% – 30%	500 000
Niveli 3	31% – 45%	600 000
Niveli 4	46% – 60%	700 000
Niveli 5	61% – 75%	800 000
Niveli 6	76% – 90%	900 000
Niveli 7	91% – 100%	1 000 000

Tabela nr. 4

4.8 Në rast të përsëritjes së shkeljeve të konstatuara nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike, nëse gjatë procesit të kontrollit konstatohet se subjekti ka përmbushur masat korrigjuese mbi nivelin e herës së parë, gjoba administrative vendoset sipas nivelit përkatës të përqindjes së mosrealizimit sipas tabelës nr.4 të kësaj metodologjie.

4.9 Në rast se niveli i përmbushjes së masave korrigjuese është i njëjtë me atë të herës së parë, pra nuk ka shënuar progres, aplikohet masa administrative maksimale në vlerën 1 000 000 lekë, në përputhje me nenin 45, pika 1, shkronja "c" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

4.10 Autoriteti, kur konstaton shkelje të përsëritura lidhur me zbatimin e masave të sigurisë kibernetike të përcaktuara në ligjin nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike" nga operatori i infrastrukturës kritike të informacionit, ndaj të cilit rezulton se janë marrë deri në 2 (dy) masa

administrative të njëpasnjëshme, aplikon masat e tjera shtrënguese sipas parashikimeve të nenit 46 të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

5. Përcaktimi i dënimit administrativ për mosraportimin nga operatorët e infrastrukturave të informacionit, të çdo infrastrukturë të re, të administruar prej tyre, që ndërvepron me infrastrukturat e kategorizuara kritike apo të rëndësishme

5.1 Bazuar në të nenin 31, pika 2, të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit janë të detyruar të raportojnë pranë Autoritetit në vazhdimësi çdo infrastrukturë të re, të administruar prej tyre, që ndërvepron me infrastrukturat e kategorizuara si kritike apo të rëndësishme.

5.2 Bazuar në përcaktimet e pikës 2, të nenit 43 të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", kur Autoriteti konstaton se nga ana e operatorëve të infrastrukturave të informacionit nuk është zbatuar detyrimi i përcaktuar në pikën 2 të nenit 31 të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike, i përcakton një afat prej 10 ditësh kalendarike brenda të cilit operatorët e infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të informacionit marrin masat për përmbushjen e detyrimit.

5.3 Bazuar në të nenin 44, shkronja "dh", të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", moszbatimi i këtij detyrimi përben kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si me poshtë vijon:

a) Operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 600 000 lekë;

b) Operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 400 000 lekë.

5.4 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 1 000 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "c" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë Kibernetike".

6. Përcaktimi i dënimit administrativ për mospërmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 1, 3, 4, 5, 7, 8, 9 të nenit 31 të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike"

6.1 Në nenin 31, pika 1, të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike" operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit kanë detyrimin të raportojnë të gjitha infrastrukturat e tyre kritike, të rëndësishme, si dhe të gjitha infrastrukturat e tjera që ndërveprojnë me to pranë Autoritetit.

6.1.1 Bazuar në nenin 44, shkronja "d", të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", mospërmbushja e këtij detyrimi përben kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë vijon:

a) Operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 5 000 000 lekë;

b) Operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 1 000 000 lekë.

6.1.2 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 10 000 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

6.2 Në pikën 3, të nenit 31 të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike" përcaktohet se operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit kanë detyrimin të

dokumentojnë çdo ndryshim dhe zhvillim të kryer në infrastrukturat e tyre kritike dhe të rëndësishme.

6.2.1 Bazuar në nenin 44, shkronja "d", të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", mospërmbushja e këtij detyrimi përben kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë vijon:

a) Operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 5 000 000 lekë;

b) Operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 1 000 000 lekë.

6.2.2 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 10 000 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

6.3 Në nenin 31, pika 4, të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike" përcaktohet se operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit kanë detyrimin të vendosin në dispozicion të Autoritetit çdo dokumentacion dhe evidencë që kërkohet nga Autoriteti në kuadër të procesit të kontrollit.

6.3.1 Bazuar në shkronjën "d", të nenit 44, të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", mospërmbushja e këtij detyrimi përben kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë vijon:

a) Operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 5 000 000 lekë;

b) Operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit sanksionohen me gjobe në vlerën 1 000 000 lekë.

6.3.2 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 10 000 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

6.4 Në pikën 5, të nenit 31, të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike" operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, në kuadër të aktivitetit mbikqyrës, i ofrojnë CSIRT-it kombëtar akses të drejtpërdrejtë në ambientet dhe sistemet e tyre të informacionit, në zbatim të procedurave të sigurisë të çdo operatori të këtyre infrastrukturave, të cilat janë të lidhura me shërbimet e ofruara prej tyre.

6.4.1 Bazuar në të nenin 44, shkronja "d", të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", mospërmbushja e këtij detyrimi përben kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë vijon:

a) Operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 5 000 000 lekë;

b) Operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit sanksionohen me gjobe në vlerën 1 000 000 lekë.

6.4.2 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 10 000 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

6.5 Në nenin 31, të pikës 7, të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", përcaktohet se për impelementimin efektiv të masave të sigurisë kibernetike, operatorët paraqesin pranë Autoritetit raportin e vlerësimit të konformitetit, nga një Organ i Vlerësimit të Konformitetit, të paktën një herë në 2 vjet.

6.5.1 Bazuar në të nenin 44, shkronja "d", të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", mospërmbushja e këtij detyrimi përben kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë vijon:

a) Operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 5 000 000 lekë;

b) Operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit sanksionohen me gjobe në vlerën 1 000 000 lekë.

6.5.2 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 10 000 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

6.6 Në nenin 31, pika 9, ë ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", përcaktohet se operatorët e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, janë të detyruar të bashkëpunojnë me Autoritetin në kuadër të realizimit të funksioneve mbikëqyrëse të përcaktuara në ligj.

6.6.1 Bazuar në nenin 44, shkronja "d", të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", mospërmbushja e këtij detyrimi përben kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë vijon:

a) Operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 5 000 000 lekë;

b) Operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit sanksionohen me gjobë në vlerën 1 000 000 lekë.

6.6.2 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 10 000 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike".

7. Përcaktimi i dënimeve administrative për mospërmbushjen e detyrimeve të operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit të administratës publike

7.1 Bazuar në nenin 32, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 25/2024, mosmarrja e konfirmimit paraprak të operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit të administratës publik nga institucioni përgjegjës për qeverisjen elektronike lidhur me specifikimet teknike, përpara inicimit të implementimit të një sistemi, si dhe mosrespektimi nga ana e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit të administratës publik i detyrimit për hostimin e nyjës primare pranë Qendrës së të Dhënave Qeveritare dhe nyjes sekondare pranë Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

a) 3 000 000 lekë për operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit;

b) 2 000 000 lekë për operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit.

7.2 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën 5 000 000 lekë, e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë Kibernetike".

8. Përcaktimi i dënimeve administrative për mospërmbushjen e detyrimeve për nëpunësit e Autoritetit, për ruajtjen e konfidencialitetit

8.1 Bazuar në pikën 1, të nenit 27, të ligjit nr.25/2024 "Për sigurinë kibernetike", nëpunësit e Autoritetit, që marrin pjesë në zgjidhjen e incidentit të sigurisë kibernetike, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e plotë për të gjitha të dhënat e përpunuara gjatë procedurës së zgjidhjes së incidentit. Konfidencialiteti duhet të ruhet edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me Autoritetin, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

8.2 Nëpunësit e Autoritetit të cilët nuk përmbushin detyrimin e përcaktuar në pikën 8.1 të kësaj metodologjie, sanksionohen me gjobë me vlerën 200 000 lekë.

8.3 Në rast të shkeljeve ligjore të përsëritura, aplikohet masa e gjobës maksimale në vlerën maksimale 400 000 lekë**,** e përcaktuar në nenin 45, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 25/2024 "Për sigurinë Kibernetike".

ANEKS 1: Pesha për secilën masë të VKM Nr.531, datë 25.09.2025 "Për përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave organizative, teknike dhe operacionale të sigurisë kibernetike dhe kategorizimin e afateve të masave korrigjuese në infrastrukturat kritike e të rëndësishme të informacionit"

Niveli	Masa	Dokumentimi	Kategorizimi	Pesha
1	Vendosja e një politike sigurie të nivelit të lartë, e miratuar nga stafi i lartë menaxherial i infrastrukturës, që adreson sigurinë e rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve kritike dhe të rëndësishme të informacionit, dhe rishikimi në mënyre periodike i saj. (Minimumi 1(një) herë në vit dhe ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI/OIRI).	Politika e Sigurisë së Informacionit Raportet e Rishikimit Periodik	Organizative	**3**
1	Krijimi i një metodologjie për menaxhimin e rrezikut kibernetik. (Rishikimi minimumi 1(një) herë në vit dhe ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI/OIRI).	Dokument i metodologjisë së menaxhimit të rrezikut kibernetikë duke përfshirë versionin, datat dhe miratimin nga stafi menaxherial. Raportet e Rishikimit Periodik	Organizative	**2**

1	Hartimi i një liste të rreziqeve për sigurinë e rrjeteve të komunikimit dhe sistemeve të informacionit, duke marrë në konsideratë kërcënimet kryesore për asetet kritike. (Rishikimi minimumi 1 (një) herë në vit dhe ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI/OIRI).	Lista e vlerësimit të rreziqeve të ardhura nga burime të ndryshme duke përfshirë dhe rreziqet të cilat vijnë nga palët e treta.	Organizative	**4**
		Njoftimi i stafit menaxherial, për listën e rreziqeve si dhe vendimi i marrë për trajtimin e tyre.		
		Rishikim i listës së rreziqeve.		
1	Hartimi i një plani për trajtimin e rreziqeve të identifikuara.	Dokument i planit për trajtimin e rreziqeve.	Organizative	**2**
		Pasqyrimi i ndryshimeve të nivelit të rrezikut mbas zbatimit të planit të trajtimit të rreziqeve.		
1	Caktimi i roleve dhe përgjegjësive për menaxhimin e sigurisë së informacionit.	Lista e roleve të sigurisë dhe përshkrimi i detajuar i përgjegjësive dhe detyrave për secilin rol p.sh. (*CISO, ISO, DPO, DBA, SYSADM, NETADM* etj.).	Organizative	**2**

		Organigrama që tregon hierarkinë dhe lidhjet midis roleve të sigurisë.		
		Lista e kontakteve për personat përgjegjës për sigurinë e informacionit (emër, pozicion, mënyra e kontaktit).		
1	Vendosja e një politike sigurie për furnizimet/ kontratat me palët e treta dhe rishikimi në mënyrë periodike i saj. (Minimumi 1 (një) herë në vit dhe ose mbas çdo incidenti të sigurisë kibernetike apo pas çdo ndryshimi madhor në infrastrukturën e OIKI/OIRI).	Politika e sigurisë për furnizimet/ kontratat me palët e treta (versioni, data e publikimit, miratimi).	Organizative	**2**
		Raporte të rishikimit periodik të politikës së sigurisë dhe ndryshimet e realizuara.		
1	Përfshirja e kërkesave të sigurisë në kontratat me palët e treta, duke përfshirë konfidencialitetin dhe transferimin e sigurt të informacionit.	Kërkesa të qarta sigurie në kontratat me palët e treta.	Organizative	**2**
		Marrëveshje konfidencialiteti për ruajtjen e informacionit me palët e treta.		
2	Mbajtja e gjurmëve/rekordeve të incidenteve të sigurisë kibernetike që lidhen ose janë të shkaktuara nga palët e treta.	Regjistri i incidenteve kibernetike të lidhura me palët e treta (data, shkaku, ndikimi, veprimet).	Organizative	**1**

1	Vendosja e një politike sigurie për burimet njerëzore.	Politika e sigurisë për burimet njerëzore (përfshirë të gjitha fazat: para rekrutimit, gjatë punësimit, proceset disiplinore, në përfundim të marrëdhënies së punësimit).	Organizative	**1**
		Dokumenti i verifikimit të integritetit të personelit kryesor (vërtetim të verifikimit të gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), referenca të punëve të mëparshme, certifikime, CV, etj...).		
		Procedura për mbrojtjen e të dhënave personale.		
1	Implementimi i një programi trajnimi për sigurinë kibernetike. (Rishikim minimumi 1 (një) herë në vit).	Programi i detajuar i trajnimit, i përshtatur sipas roleve dhe përgjegjësive të punonjësve.	Organizative	**2**
		Lista e pjesëmarrësve dhe datat e trajnimeve.		
		Dokument i realizimit të fushatave të ndërgjegjësimit/trajnimeve të punonjësve në lidhje me sigurinë kibernetike dhe sulmet e sigurisë kibernetike më të shpeshta si "*Phishing", "Malware",* etj.		

1	Informimi dhe trajnimi i punonjësve të rinj mbi politikat dhe procedurat në fuqi për sigurinë kibernetike.	Evidenca mbi trajnimin për punonjësit e rinj. Formularë të nënshkruar nga punonjësit për njohjen e politikave dhe procedurave. Formularë të nënshkruar nga punonjësit për Marrëveshjen e Konfidencialitetit ("NDA" - *Non Disclosure Agreement)*.	Organizative	**2**
2	Testimi i njohurive të punonjësve mbi sigurinë kibernetike. (Minimumi 1(një) herë në vit për punonjësit të cilët përdorin sistemet kritike të informacionit në infrastrukturë dhe ose më shpesh në varësi të incidenteve kibernetike.)	Pyetësorë dhe rezultate testimi për ndërgjegjësimin e punonjësve në lidhje me sigurinë kibernetike.	Organizative	**1**
